

URDHËR
Nr. 28, datë 12.3.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”; të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe të urdhrit të Komisionerëve Publikë nr. 27, datë 12.3.2024, “Për shfuqizimin e kompetencave të deleguara”,

URDHËROJMË:

1. Kompetencat e titullarit të Autoritetit Kontraktor, për procedurat e prokurimit në Institucionin e Komisionerëve Publikë, të kryhen nga z. Florian Ballhysa, Komisioner Publik.

2. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.

Ky urdhër hyn në fuqi në datën 12.3.2024 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERËT PUBLIKË
Florian Ballhysa, Irena Nino